



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.85/2021

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, kryetar, Muhamet Rexha dhe Shukri Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike disiplinore ndaj D. M., Gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Kosovës në P., kundër Këshillit Gjyqësor të Kosovës (më tej KGJK), për shkak të shqiptimit të masës disiplinore, duke vendosur sipas ankesës së Gjyqtarit D. M., paraqitur përmes të autorizuarit, avokat Artan Qerkini, kundër vendimit Këshillit Gjyqësor të Kosovës KGJK nr.346/2021, datë 15.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur më 20.12.2021 merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa themeltë, ankesa e D. M., Gjyqtar në Gjykatën e Apelit të Kosovës në P., e paraqitur përmes të autorizuarit, avokat Artan Qerkini, kundër vendimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK nr.346/2021, datë 15.11.2021.

A r s y e t i m

Me vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK nr.346/2021, datë 15.11.2021, në pikën 1 të dispozitivit ishte vendosur që D. M., gjyqtar në Gjykatën e Apelit, është përgjegjës për shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 5, paragrafi 1, pika 1.3, neni 5, paragrafi 2, pika 2.9 dhe 2.15, të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Në pikën 2 të

dispozitivit të këtij vendimi ishte vendosur se për këtë shkelje disiplinore gjyqtarit D. M. i shqiptohet sanksioni disiplinor "*Transferim i përhershëm në Gjykatën Themelore në P.,- Departamenti i Përgjithshëm*".

Kundër këtij Vendimi, gjyqtari D. M., përmes të autorizuarit, avokat Artan Qerkini, në afat ka paraqitur ankesë, për shkak të: zbatimit të gabuar të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve; zbatimit të gabuar të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë; cenimit të së drejtës për mbrojtje; vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në lidhje me sanksionin disiplinor me propozim që të aprovohet ankesa e subjektit në procedurë D. M. si e bazuar të anulohet Vendimi KGJK.nr.346/2021, dt. 15.11.2021 dhe gjyqtari D. M., të lirohet nga përgjegjësia disiplinore, ose lënda të kthehet në rivendosje.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës në përgjigje ndaj ankesë së gjyqtarit, pretendon se ankesa është e pa bazuar dhe se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë, sepse janë zbatuar në tërësi dispozitat e Ligjit mbi Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, sa i përket procedurës dhe kualifikimit të shkeljes, andaj i propozon Gjykatës Supreme që ta refuzoi ankesën si të pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të vendimeve të atakuar në kuptim të nenit 15 të Ligjit për përgjegjësinë disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, më datë 10.08.2021, ka pranuar kërkesë nga Autoriteti Kompetent në kuptim të nenit 2 pika 1, nën-pika 1.1 e Ligjit mbi Përgjegjësinë Disiplinore për Gjyqtarë dhe Prokurorë, me pretendim se z. D. M., gjyqtar në Gjykatën e Apelit, mund të ketë kryer shkelje disiplinore nga neni 5, paragrafi 1, pika 1.3, neni 5 paragrafi 2, pika 2.9 dhe 2.15, të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, përmes së cilës ka kërkuar nga Këshilli, si organ kompetent të filloj hetimin disiplinor, me ç'rast ka propozuar që ndaj të njëjtit në rast se vërtetohet se ekziston shkelja disiplinore nga gjyqtari M., t'i shqiptohet njëra nga sanksionet disiplinore të parapara në dispozitën e nenit 7 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Autoriteti Kompetent, kërkesës së lartcekur i ka bashkangjitur edhe

incizimet e bisedave telefonike të publikuara më datë 4.08.2021, në gazeta dhe portale të vendit, në bazë të cilave incizime është i përfshirë edhe gjyqtari M., duke kërkuar inicimin e hetimit disiplinor.

Këshilli, me vendimin e vet KGJK.nr.222/2021, të datës 13.08.2021, ka themeluar Panelin Hetimor për lëndën disiplinore me numër Nr.AD/KGJK/08/2021/GJA-AGJ.nr.625/2021, të datës 12.10.2021. Ky Panel i ka paraqitur Këshillit, raportin me shkrim lidhur me hetimin e bërë për shkeljen e pretenduara të Gjyqtarit D. M.

Këshilli me datë 8 dhe 15.09.2021, ka mbajtur seanca dëgjimore, pas pranimit të Raportit nga Paneli Hetimor, për të shqyrtuar këtë çështje disiplinore, ku kanë marrë pjesë Kryesuesi i Panelit Hetimor dhe avokati Artan Qerkini, i autorizuar nga subjekti i hetimit disiplinor gjyqtari D. M.

Në arsyetimin e KGJK-se, thuhet se kryesuesi i Panelit Hetimor në seancën dëgjimor, me datë 29.09.2021, ka marrë vendim që ti drejtohet Prokurorisë Themelore në P., me kërkesë për informacion se "a është ndërmarr ndonjë veprim ligjor lidhur me këtë çështje?", dhe nga Prokuroria Themelore në P., Paneli Hetimor ka pranuar përgjigje më datë 15.09.2021, më të cilën është njoftuar se lidhur me rastin e përgjimeve të publikuara në portalin "shqip.com", me datë 30.08.2021, prokuroria ka lëshuar autorizim për grumbullimin e informatave, nën shenjen RRNI.nr.385/2021, në drejtim të veprës penale "Përgjim i pa autorizuar" nga neni 201 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Faktet e gjetura të Panelit Hetimor janë se subjekti hetimor ka biseduar në telefon me personin H. S., i cili i ka kërkuar subjektit të hetimit që të bisedoj me Kryeprokurorin e Shtetit Aleksandër Lumezin lidhur me një veturë të konfiskuar, me ç'rast subjekti i hetimit i ka premtuar personit H. S., se do të kontaktoj Kryeprokurorin e Shtetit lidhur me çështjen e veturës së konfiskuar. Subjekti i hetimit në seancë ka pranuar se ka biseduar në telefon me personin H. S. Paneli Hetimor, ka konstatuar se nuk kanë pasur informacion se Kryeprokurorin Lumezi ka ndërmarrë ndo një veprim për të ndikuar në lirimin e veturës së konfiskuar. Nga incizimet sipas vlerësimit të Panelit Hetimor nuk ka informacion se gjyqtari D. M., ka kërkuar diçka për këtë çështje, dhe që bashkëbiseduesi H. S. ti ketë ofruar shpërblim subjektit të hetimit gjyqtarit D.M.

Paneli Hetimor, për të vërtetuar faktet, raportit i'a ka bashkangjitur edhe provat materiale si: transkriptet e bisedave që janë bërë në mes subjektit të hetimit dhe personit anonim se bashku me materialet e botuara në gazetën Shqip.com; CD-ja, që përmban biseda të publikuara në gazetën shqip.com; Shkresa e ushtruesit të detyrës së Kryetarit të Gjykatës së Apelit për inicimin e procedurës disiplinore të datës 10.08.2021; Shkresa e drejtuar KGJK-së, për dorëheqje nga gjyqtari D. M., të datës 6.08.2021; Kërkesën me shkrim të datës 14.09.2021 drejtuar Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë z. Kujtim Munishi, në lidhje me marrjen e informatave se a është iniciuar ndonjë procedurë hetimore në lidhje me rastin e përgjimeve; Përgjigjen me shkrim nga Prokuroria Themelore në P., të datës 15.09.2021 dhe deklaratën e gjyqtarit D. M., e dhënë në seancën dëgjimore me datë 29.09.2021 me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi kërkesën e iniciuar nga organi kompetent. Paneli Hetimor gjithashtu si pjesë të raportit ka sjell edhe një pjesë të deklaratës se gjyqtarit D. M., audio incizimi dhe transkripti i audio incizimit që gjendet në shkresat e lëndës disiplinore.

Avokati i subjektit të këtij hetimi disiplinor, z. Artan Qerkini, në seancën dëgjimore të KGJK-së të mbajtur me datë 8 dhe 15 nëntor 2021, ka deklaruar se duke shtuar se bazuar në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk do të vërtetohet se z. M., ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara në Ligjin për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Më tutje, avokati Qerkini ka deklaruar se asnjë provë e vetme nuk thotë që z. M., të ketë ndërhyrë, në mënyrë të kundërligjshme, ngase dispozita e nenit 5, paragrafi 2.2.9, konsideron shkelje nga ana e gjyqtarit nëse ai ndërhyrë tek një gjyqtar apo prokurorë. Këshilli në seancën dëgjimore të mbajtur më 8 nëntor 2021, ka miratuar propozimin e avokatit të subjektit të hetimit që në cilësinë e dëshmitarit të dëgjohet A. L. Në seancën e datës 15 nëntor 2021, dëshmitari A. L., ka deklaruar se është në dijeni të përmbajtjes së është në dijeni se ndaj dëshmitarit personit H. S., nuk ka qenë duke u zhvilluar procedurë penale.

Për ta vërtetuar faktet në këtë çështje disiplinore Këshilli administroj dhe vlerësoj këto prova: Kopjen e komunikimit të publikuar me datë 4 gusht 2021, ora 9:59, me titull “Çka ke me L., fol me mu”; Lajmin e publikuar në shqip.com, që është vazhdimin - titulli ekskluzive, shantazh, pastrim figurash, emërimë nëpër poste; Publikimi në shqip.com, titulli flet Kryeprokurori Lumezi, bashkë me vazhdimin; E-mail i gjyqtarit D. M., për dorëheqjen si anëtar i

Këshilli; Shkresa drejtuar Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, z.Munishi, datë 10.09.2021; informacioni nga A. S., i datës 9.10.2021, e-mail; Transkriptimi i nxjerr nga portalet shqip.online nga IT; Shkresa e datës 15.09.2021, A.nr.296/2021 nga Paneli hetimor për Prokurorinë Themelore në Prishtinë; Shkresa e datë 14.09.2021; Kërkesë për informacion nga Kryeprokurori Munishi, në këtë rast nga Kryesuesi i Panelit z.A. S.; Procesverbali i përpiluar me datë 10 shtator 2021;Transkripti nga seanca e Panelit Hetimor të mbajtur me datë 29 shtator 2021, ditë e mërkure.

Pas vlerësimit të provave të administruara dhe deklaratës së subjektit të hetimit, Këshilli konstatoj se gjyqtari D. M. ishte përfshirë në bisedat e regjistruara telefonike me bashkëbiseduesin H. S., biseda këto të publikuara në portalin shqip.com, me datë 4.08.2021, si dhe në gazeta dhe portale tjera. Gjatë regjistrimeve telefonike të publikuara në shqip.com është dëgjuar që gjyqtari D. M. ti ketë thënë bashkëbiseduesit H. S., citoj “çka ke me L., fol me mu”. Sipas shkresave të lëndës dhe të arsytimit të KGJK-së, vet gjyqtari D. M., në seancën dëgjimore, para Panelit Hetimor, të mbajtur me datë 29.09.2021, ka pranuar se ka biseduar në telefon me personin H. S., i cili kishte kërkuar nga i njëjti që të bisedoj me Kryeprokurorin Aleksandër Lumezi, lidhur me një veturë të konfiskuar.

Këshilli në bazë të provave të administruara ka gjetur se gjyqtari Muharremi është përfshirë në shkelje disiplinore të pretenduara nga autoriteti kompetent pasi që komunikimi i tij me personin H. S., kualifikohet si shkelje nga neni 5 të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Po ashtu, Këshilli ka vlerësuar se komunikimi i gjyqtarit me personin H. S., dhe pastaj me dëshmitarin e këtë çështje disiplinore i konsumon të gjitha elementet e shkeljes disiplinore për të cilën është shqiptuar masa disiplinore,

Këshilli ka vlerësuar se sjellja e gjyqtarit Muharremi, përbën shkelje nga neni 2 pika 2.9 të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve sepse veprimet e tij cilësohen si ndërhyrje në veprimet e prokurorit me qëllim ndërhyrje dhe rrjedhimisht edhe shkelje nga neni 2 pika 2.15, sepse me veprimet e tij e ka dëmtuar reputacionin e gjykatës dhe ka dëmtuar besimin e publikut në besueshmërinë e gjyqësorit. KGJK ka konstatuar se me veprimet e gjyqtarit M., sidomos pas publikimit të përgjimeve është dëmtuara rënd reputacioni i figurës së

gjqtarit dhe gjithashtu është dëmtuara rënd imazhi i sistemit gjyqësor. Veprimet e gjyqtarit M., i kanë cenuara parimet bazë të funksionimit të sistemit gjyqësor dhe përgjegjësisë që ka gjyqësori për të promovuar vlerat e trajtimit të barabartë të qytetarëve para ligjit dhe para gjykatës si dhe vlerat që publiku të besoj në drejtësi të paanshëm i reziston çfarëdo ndërhyrje.

Gjykata Supreme e Kosovës, nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, është i drejt dhe i ligjshëm, pasi që vendimi i atakuar është i ligjshëm dhe është marrë me zbatimin e drejtë të së drejtës material kur është vërtetuar përgjegjësia disiplinore e gjyqtarit D. M., për shkeljen e Kodit të Etikës, konkretisht nenit 5, paragrafi 2 pika 2.9 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe vendimi përkitazi me masës e shqiptuar disiplinore të marrë për këto shkelje në pajtim me nenin 7, paragrafi 1, pika 1.4.

Gjykata Supreme e Kosovës pajtohet me qëndrimin se shkeljet e sipër theksuara janë provuar gjatë administrimit të provave, të cilat i janë prezantuar Këshillit, nga raporti fakt mbledhës i Panelit Hetimor i cili është vlerësuar si raport i besueshëm pasi që në mënyrë objektive dhe sipas procedurës së përcaktuar ligjore Paneli ka zhvilluar procesin e hetimit të çështjes dhe konstatimit të fakteve. Siç del nga shkresat e lëndës, Këshilli i ka vlerësuar pretendimet e subjektit të hetimit, përfaqësuesit të tij dhe deklaratën e dëshmitarit , por ka gjetur se në kuptim të fakteve të konstatuara me provat e administruara këto pretendime dhe deklarata nuk kanë ndikuar që Këshilli të marr një vendim tjetër. Ky qëndrim i KGJK-së u miratua edhe nga kjo gjykatë për faktin se procedura dhe masa e shqiptuar janë në pajtim me ligjin.

Pretendimi ankimor për cenim të drejtës në mbrojtje nuk u argumentua me asnjë provë. KGJK në pajtim me ligjin ka formuar panelin hetimor për të shqyrtuar pretendimet e autoritetit kompetent. Paneli ka zhvilluar hetim në përputhje me ligjin dhe ka administruar procesin duke i dhënë mundësi deklarami subjektit hetimor për përgjigje në çdo pretendim. Këshilli më datë 8 dhe 15.09.2021, ka mbajtur seanca dëgjimore, pas pranimit të Raportit nga Paneli Hetimor, për të shqyrtuar këtë çështje disiplinore. Në pajtim me ligjin është zhvilluar hetimi dhe mbi bazën e këtij hetimi KGJK ka shqiptuar masën disiplinore si në dispozitivin e Vendimit të atakuar me ankesë.

Gjykata Supreme e Kosovës e aprovon edhe qëndrimin se masa disiplinore e shqiptuar është proporcionale me shkeljen e konsumuar nga ana e subjektit të hetimit dhe është në zbatimin e përgjegjësive ligjore që ka Këshilli Gjyqësor në procedurën disiplinore ndaj gjyqtarëve, sipas Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Gjykata Supreme gjene se janë zbatuar drejtë dispozitat e nenit 15 të Ligjit që rregullojnë çështjen e ankimit ndaj vendimeve të KGJK-së, pranë Gjykatës Supreme të Kosovës dhe pika 4 e këtij neni parasheh se ankesa ndaj vendimeve të Këshillit mundë të ushtrohet në rast të zbatimit të gabuar të Ligjit (4.1) dhe në rast në rast të një gabimi faktik të qartë apo të dukshëm i cili ndikon në të drejtat substanciale të palës në qoftë se ndikon seriozisht në paanësinë dhe integritetin e procedurës (4.3).

Bazuar në shkresat e lëndës dhe arsyetimin e Vendimit të KGJK-së, Gjykata Supreme e Kosovës gjeti se ankesa e subjektit hetimore, e ushtruar ndaj vendimit të KGJK-së nuk mbështetet në fakte. Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka vepruar në përputhshmëri me dispozitat e Ligjit në fuqi për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve ka dëshmuar se është bërë shkelje disiplinore nga parashtruesi i ankesës, i ka shqiptuar masën disiplinore në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe ka marrë parasysh edhe seriozitetin, pasojat, rrethanat në të cilat është kryer shkelja. Prandaj pretendimet e ankesës për aplikim të gabuar të së drejtës materiale janë të pa bazuara dhe si të tilla u refuzuan.

Pretendimi ankimor se arsyetimi i Vendimit është kundërthënës dhe njëherit paraqet zbatim të gabuar të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe Kodit të Etikës Profesionale, nuk u mbështet me asnjë fakt dhe është i pa qëndrueshëm konstatimi se KGJK nuk ka dhënë arsye për faktet vendimtare duke theksuar vetëm faktet dhe vlerësimet por pa i arsyetuar ato. Për më tepër pretendimi ankimor se Gjyqtari në rastin e bisedës nuk ka vepruar si gjyqtar, sepse sipas pretendimeve ankimore, për të vepruar si gjyqtarë, duhet që pala me të cilën ka zhvilluar bisedë të ketë çështje të ngritur dhe po ajo çështje ti jetë ndarë gjyqtarit subjekt proceduralë dhe i hetimit është konstatim i pasaktë dhe nuk mbështetet në ligj sepse në arsyetimin e Vendimit nga KGJK me të cilin pajtohet edhe Gjykata Supreme e Kosovës me të drejtë thuhet se me dispozitën e nenit 2, paragrafi 2.1, të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë, përcaktohet është përcaktuar se: “gjyqtari me sjelljen e tij në gjykatë dhe jashtë gjykatës ruan dhe avancon besimin e publikut dhe palëve në paanshmërinë e tij dhe gjyqësorit në

përgjithësi”, ndërsa në nenin 4 paragrafi 4.1, përcaktohet se: “gjqytari si bartës i funksionit të rëndësishëm publik dhe që i nënshtrohet vazhdimisht mbikëqyrjes nga publiku, sipas vullnetit të lirë pranon kufizimet që i imponon funksioni që ushtron”.

Edhe pretendimet e palës ankuese për zbatim të gabuar të Kodit të Etikës profesionale për gjyqtarë nuk aprovua nga kjo gjykatë për faktin se në arsyetimi i dhënë nga KGJK është bërë aplikim i drejtë i dispozitës së nenit 4 paragrafi 4.5, të Kodit të Etikës Profesionale për Gjyqtarë, ku përcaktohet se: “gjqytari nuk do të lejojë që relacionet e tij familjare, shoqërore apo tjera të ndikojnë në mënyrë të pandinjitetshme në ushtrimin e funksionit të tij”. Ndërsa në paragrafi 4.6 përcaktohet se: “ gjyqtari në asnjë rrethanë nuk do të shfrytëzojë pozitën e tij gjyqësore as t'i lejojë të tjerët që ta shfrytëzojnë pozitën e tij për interesa private”.

Prandaj nëse i referohemi dispozitës së nenit 5, 2 pika 2.9 përcaktohet ndërhyrja në veprimet e gjyqtarëve dhe prokurorëve të tjerë me qëllim të ndikimit në aktivitetet dhe vendimet e tyre në çfarëdo mënyre të ndaluar me ligj, ndërsa me dispozitën e nenit 2.15 përcaktohet se “përfshihet në sjellje, qoftë kur është në detyrë apo privatisht, të cilat dëmtojnë reputacionin e gjykatës ose mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e gjyqësorit” del qartazi se gjyqtari, subjekt i hetimit e ka konsumuar shkeljen për të cilën ngarkohet dhe se kjo shkelja është e paraparë në përputhje me nenit 5.2.15, të Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, i cili parasheh se Gjyqtari kryen shkelje disiplinore nëse përfshihet në sjellje, të cilat dëmtojnë reputacionin e gjykatës ose mund të dëmtojnë besimin e publikut në paanshmërinë ose besueshmërinë e gjyqësorit" dhe sanksioni disiplinor është në përputhje me nenin 7 paragrafi 1 pika 4; të njëjtit ligj i cili parasheh edhe sanksionin disiplinor.

Prandaj sipas Gjykatës Supreme të Kosovës është zbatuar procedura e paraparë sipas ligjit në fuqi dhe masa e dhënë është në përputhje me parimin e proporcionalitetit duke marrë parasysh: seriozitetin e shkeljeve disiplinore të kryera nga gjyqtari, pasojat e shkeljes disiplinore; rrethanat në të cilat është kryer shkelja disiplinore; Ky sanksion disiplinor i shqiptuar është në përputhje me shkeljet e gjetura si në raportin e Panelit hetimor ashtu siç parashihen në nenin 7 paragrafi 2 i Ligjit Nr.06/L-057 për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve. Prandaj, parashtrimet në ankesë lidhur me masën disiplinore të shqiptuar u refuzuan si të pa bazuara sepse si të tilla nuk dëshmuar zbatimit të gabuar të Ligjit (Neni 15 pika 4.1) apo ndonjë

gabimi faktik të qartë apo të dukshëm i cili do të ndikonte në të drejtat substanciale të palës apo në paanësinë dhe integritetin e procedurës(Neni 15 pika 4.3) .

Nga sa u tha në ankesë e në pajtim me nenin 15.6 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

AA.nr.85/2021 më 20.12.02021

Kryetari i Kolegjit

Beshir Islami